



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË  
ZYRË E PERMBARIMIT PRIVAT "QEVA" SH.P.K



Nr. 120/Regj  
10

Pogradec më 24.09.2021

URDHËR

**"PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE"**

Drejtuar : Qendra Kombëtare e Biznesit, QKB  
Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona Nr 33, Tiranë.



Drejtuar debitorit : Shoqëria "MIKA KORCA" sh.a, me NIPT – J64103104K, me administrator 1-Spyridon Anthomelidis ,me përfaqësues ligjor Av.Alfred Cerepi me licensë nr.2036 me NIPT J64103104K, vendim nr.974 datë 10.09.2019 I Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

**Për djeni kreditorit: person fizik Petrit Noto me NIPT L54618047U**  
Adresa : Biranjë , Korçë.

Në Rregjistrin e Titujve ekzekutiv të Zyrës së Përmbarrimit Privat Qeva sh.p.k, me kërkesë të palës kreditore më datën 25.03.2019, është regjistruar çështja përmbarrimore me numër 120 regjistri me palë :

**Kreditor : Petrit Noto**  
**Debitor : Shoqëria "MIKA KORCA" sh.a.**  
**Me objekt : Pagimi i Faturës Tatimore**

Unë përmbarruesi gjyqësor Erzen Qeva, pasi shqyrtova materjalin e plotë të dosjes përmbarrimore :

**KONSTATOVA :**

Në titullin ekzekutiv, Fatura Tatimore me Nr.102, datë 02.03.2017, me nr serie 41969302 ,lëshuar për kontratën Nr. 2741 datë 02.03.2017, për të cilën është lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, vendimi i Urdhërit të Ekzekutimit me Nr.41-209-1014(81 UE), datë 15.03.2019 është vendosur detyrimi i debitorit Shoqëria "MIKA" sh.a, ti paguajë detyrimin në shumën prej 213.523( Dyqind e trembëdhjetë mijë e pesëqind e njëzet e tre) lekë, plus interesat ligjore në shumën 11.029 (Njëmbëdhjetë mijë e njëzet e nënëte )lekë, plus kamatat ditore nga data 28/10/2019 deri sot 12/11/2019 (16 ditë\*10 lekë)= 160 lekë të llogaritura sipas Raport -Ekspertimit të datës 30/10/2019 me vlerësues Robert Bregun të caktuar sipas vendimit për caktimin e ekspertit me nr 120/4 të datës 27/10/2019.

-Debitori është i detyruar të paguajë tarifën e shërbimit përmbarrimor, sipas Udhezimit me Nr.385/7, të datës 28.06.2017, "Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarrimor gjyqësor privat", I ndryshuar në vlerën 26.400 lekë, me TVSH.

-Debitori është i detyruar të paguajë dhe shpenzimet e kryera mbi ekspertin në shumën 24.000 lekë ,të parapaguara nga kreditori, sipas nenit 525 K.Pr.Civile.

-Debitori është I detyruar të paguajë dhe shpenzimet e avokatisë në shumën 48.000 lekë për avokatin Alfred Cerepi,përfaqësues ligjor I debitorit Shoqëria “MIKA KORCA” sh.a, sipas vendimit nr.974 datë 10.09.2019 I Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korcë.

**Në total detyroheni të paguani detyrimin, plus kamatvonesat deri në këtë moment, përfshirë tarifën përbarimore dhe shpenzimet e ekspertit, në total shumën 323.112(Treqind e njëzet e tre mijë e njëqind e dymbëdhjetë)lekë.**

Afati i ekzekutimit në mënyrë vullnetare ka kaluar dhe pala debitore nuk ka respektuar afatin ligjor për ekzekutim vullnetar. Në këto kushte ekzekutimi i titullit do të vazhdojë në ekzekutim të detyrueshëm për vjeljen e detyrimit, ku do të vendoset sekuestro konservative në llogaritë e palës debitore , si dhe do të parashikohen saksione ndaj personit përgjegjës të ngarkuar nga ligji për pengim të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.

**Për këtë arsye : Në bazë të neneve 527 e në vijim të K.Pr.Civile**

### URDHËROJMË

1 - Vendosjen e masës së sekuestros konservative, mbi kuotat/aksionet, e pales debitore **Shoqëria “MIKA KORCA SHA” shpk, me NIPT- J64103104K, me Adm Spyridon Anthomelidis** , për shlyerjen e detyrimit në shumën 323.112(Treqind e njëzet e tre mijë e njëqind e dymbëdhjetë)lekë përfshirë ktu detyrimi dhe tarifa e shërbimit përbarimor,dhe shpenzimet e kryera gjatë ekzekutimit.

2-Mbi të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i këtyre kuotave duke ndaluar tjetërsimin dhe/ose disponimin e tyre si dhe mos kryerjen e asnjë veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrit tregtar. Dokumentacioni do të qendrojë i bllokuar deri në një urdhër të dytë nga ana jonë.

3- Për veprimin apo mosveprimin tuaj,duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

4- Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren masat e parashikuara në neni 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.

5- Ky urdhër mbahet e ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.C kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brenda 5 ditëve nga marja dieni.

### **ZYRË E PËRMBARIMIT PRIVAT “QEVA”- SH.P.K PËRMBARUESI GJYQËSOR**

**Erzen QEVA**

